



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 488

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDËRRIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR. 2553/00, ME QV NR.2553/01, BASHKIA BELSH, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor.

Në KQZ, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, është administruar propozimi i Kryetarit të Bashkisë Belsh, duke referuar si më poshtë:

“Në dy qendrat e votimit, konkretisht QV nr.2553/00 dhe QV nr.2553/01 është bërë një ngatërresë, ku zgjedhësit e QV nr.2553/00 me vendndodhje në ambientin privat të z. Ylli Tafani, janë regjistruar tek QV nr.2553/01 me vendndodhje në ambientin privat të z. Kadri Tafani, dhe anasjelltas. Duke referuar gjithashtu se njoftimi i zgjedhësve shtëpi më shtëpi është bërë (pa vënë re emërtimin) duke i përmendur votuesve emërtimin e lokaleve. Qendrat e votimit janë të dyja në territorin e fshatit Gradisht dhe distanca midis tyre është rreth 600m”.

Bashkia Belsh kërkon ndërrimin e vendndodhjes së QV nr.2553/00 me vendndodhjen e QV nr.2553/01, për mos të krijuar probleme me zgjedhësit ditën e zgjedhjeve.

Data: 11.5.2023 Nr: 488
Ora: 12:00



“Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 2553/00, me QV nr.2553/01, Bashkia Belsh, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 2553/00 nga ambienti i z. Ylli Tafani në ambientin e z. Kadri Tafani, dhe ndërrimin e vendndodhjes së QV nr. 2553/01 nga ambienti i z. Kadri Tafani në ambientin e z. Ylli Tafani.
2. Kryetari i bashkisë të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, sipas këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI